



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2021

VENDIM
Nr. 213, datë 26.05.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT ENTON DHIMITRI,
PËR VITIN 2019

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Enton Dhimitri, për vitin 2019”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Enton Dhimitri, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

RAPORT
I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL
TË GJYQTARIT

Tiranë më 26.05.2021

Ekstrakt

**ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT
DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI.**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari në bazë të kategorisë së çështjes (*civile themeli ose penale themeli*), përshkruan në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit faktet e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, si gjatë gjykimit në shkallë të parë, ashtu edhe gjatë gjykimit në apel, në ato çështje kur gjykata e apelit ka vendosur që të përsërisë pjesërisht shqyrtimin gjyqësor të çështjes.¹ Në një rast gjyqtari nuk përshkruan faktet e çështjes, por përshkruan rrethanat procedurale, për shkak të natyrës së disponimit të gjykatës për mospranimin e ankimit, rrjedhojë e kalimit të afatit të ankimit.²

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, përgjithësisht, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, gjyqtari e përcakton natyrën e çështjes objekt

¹ Vendimi civil nr.20-2019-392/173, datë 07.05.2019; Vendimi penal nr. 20-2019-1014/114, datë 24.12.2019;

² Vendimi penal nr. 20-2019-35/11, datë 16.01.2019;

shqyrtimi. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, në rastet kur kjo gjykatë ka gjykuar si gjykatë e shkallës së parë, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.³

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet e vëzhguara rezultojnë se gjyqtari ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dhe herë pas here duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural, të Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Penal, Kodit të Punës, të Kodit Civil dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Sa i përket ligjit procedural, në vendimet penale gjyqtari ka referuar dhe cituar si pjesë të arsytimit të vendimit, nenin 425/1 të K.Pr.Penale, të ndryshuar me ligjin nr.35/2017, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, referuar shkaqeve të ankimit të të akuzuarit; nenet 59, 388/b dhe 428/1 të K.Pr.Penale në funksion të argumentimit të së drejtës së viktimës akuzuese për të kërkuar ndjekjen penale drejtpërdrejt në gjykatë për një kategori të caktuar veprash penale (*vendimi nr. 1014/114, datë 24.12.2019*); nenet 415/1 dhe 420/2 të K.Pr.Penale para ndryshimeve, në funksion të pasojave juridike që rrjedhin për shkak të kalimit të afatit të ankimit (*vendimi nr. 35/11, datë 16.01.2019*).

Po kështu, në vendimet civile gjyqtari ka referuar dhe cituar nenin 465/1 të K.Pr.Civile, të ndryshuar me ligjin nr.38/2017, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të ankimit; nenet 32/a dhe 95 të K.Pr.Civile në lidhje me interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë (*vendimi nr.392/173, datë 07.05.2019*); nenin 253 të K.Pr.Civile në lidhje me fuqinë provuese të akteve zyrtare; nenin 459 të K.Pr.Civile për rënien në dekadencë të kërtimeve apo pretendimeve të palëve (*vendimi nr.447/197, datë 21.05.2019*); nenin 207 të K.Pr.Civile në funksion të kriterëve ligjore për zëvendësimin e masës së sigurimit (*vendimi nr.23/14, datë 11.01.2019*) etj.

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, në vendimet civile gjyqtari ka identifikuar dhe referuar dispozitat e ligjit material, konkretisht nenin 663 të K.Civil, në lidhje me kushtet e nevojshme për ekzistencën e një kontrate në raport me pasojat e mungesës së këtyre kushteve në kuptim të nenit 92, shkronja “a”, të K.Civil; nenin 111 të K.Civil lidhur me pavlefshmërinë e pjeshme të veprimit juridik (*vendimi nr. 1014/114, datë 24.12.2019*); nenet 144, 153/3, 153/4, 154/3, 155/1 të K.Punës, si norma relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi (*vendimi nr. 782/338, datë 10.10.2019*). Gjyqtari citon dispozitat materiale të ligjit të posaçëm nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronës: nenet 20 dhe 27, në lidhje me kërkesat e patrajuara më parë, për të cilat nuk ka pasur ndonjë vendimmarrje të mëparshme për njohjen apo jo të së drejtës së pronësisë (*vendimi nr. 291/8, datë 04.04.2019*).

Në vendimin penal (*vendimi nr. 1014/114, datë 24.12.2019*) gjyqtari ka identifikuar dhe referuar dispozitat e ligjit material, konkretisht nenet 119, 120, 121 dhe 122 të K.Penal, lidhur me ekzistencën e faktit penal.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet e vëzhguara nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore, për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

³ Vendimi civil nr. 20-2019-291/8, datë 04.04.2019;

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe bën përshkrimin e tyre duke i ndërthurur me provat e administruara në gjykim. Gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale të akteve ligjore dhe nënligjore që gjejnë zbatim mbi faktin objekt shqyrtimi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtari në përputhje me rrethanat procedurale dhe faktike të çështjes objekt shqyrtimi si dhe shkaqeve të ngritura në ankim, referon, citon dhe interpreton norma të ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore, me qëllim mbështetjen e konkluzioneve të arritura lidhur me zbatimin e tyre në zgjidhjen e çështjes.

Konkretisht, në lidhje me normat procedurale, gjyqtari ka interpretuar normat procedurale në disa raste, si më poshtë:

- Interpreton nenin 425/1 të K.Pr.Penale, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në Apel, referuar ndryshimeve të K.Pr.Penale me ligjin nr. 35/2017, në funksion të argumentimit se në përputhje me karakterin detyrues të rregullit të përcaktuar në nenin 425/1 të K.Pr.Penale, shqyrtimi gjyqësor i çështjes në shkallë të dytë të gjykimit kufizohet brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Gjyqtari interpreton nenet 59, 388/b dhe 428/1 të K.Pr.Penale, në funksion të argumentimit të së drejtës së viktimës akuzuese për të kërkuar ndjekjen penale drejtpërdrejt në gjykatë për një kategori të caktuara veprash penale (*vendimi nr. 1014/114, datë 24.12.2019*);
- Interpreton nenet 465/1, 32/a dhe 95 të K.Pr.Civile lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel, kufijtë e shqyrtimit të ankimit dhe interesin e ligjshëm të padisë, si dhe interpreton nenin 273 K.Pr.Civile, lidhur me provimin e falsitetit të një shkrese (*vendimi nr. 392/173, datë 07.05.2019*);
- Gjyqtari interpreton nenin 388 të K.Pr.Civile, duke analizuar kriteret për ngritjen e kërkesës për vërtetim fakti, si interesi i ligjshëm, mungesën e aktit dhe pamundësinë e ribërjes së tij, apo marrjen e aktit në ndonjë rrugë tjetër; interpreton përmbajtjen e nenit 29 të K.Pr.Civile në raport me provat e administruara në gjykim (*vendimi nr. 749/110, datë 02.10.2019*);
- Interpreton në mënyrë gramatikore dhe ligjore nenin 207 të K.Pr.Civile për zëvendësimin e masës së sigurimit “Sekuestro konservative”, në raport me kriteret ligjore për zëvendësimin e kësaj mase dhe në raport me faktet e provuara në gjykim (*vendimi nr. 23/14, datë 11.01.2019*);
- Interpreton nenin 467, shkronja “e”, të K.Pr.Civile, të ndryshuar me ligjin 38/2017, në raport me nenin 121 të K.Pr.Civile, në të cilin parashikohet pavlefshmëria e pjeshme e aktit procedural, me qëllim disponimin mbi prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim (*vendimi nr.872/338, datë 10.10.2019*);

- Interpreton nenet 451/a dhe 451 të K.Pr.Civile në funksion të parimit të “gjësë së gjykuar” (*vendimi nr. 291/8, datë 04.04.2019*).

Në lidhje me dispozitat materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, në vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtari, përveç citimit, ndalet edhe në interpretimin ligjor të tyre dhe më pas vijon me aplikimin mbi faktet konkrete, për të mbështetur konkluzionet e arritura lidhur me çështjen. Konkretisht, rezulton të jenë interpretuar dispozitat ligjore materiale si më poshtë:

- Gjyqtari, interpreton në mënyrë gramatikore dhe literale nenin 121 të K.Penal (si para ndryshimeve të tij me ligjin nr. 44/2019, edhe pas këtyre ndryshimeve) në funksion të kualifikimit juridik të faktit penal për të cilin akuzohet i pandehuri, mbështetur në rrethanat e faktit dhe provat përkatëse (*vendimi nr. 1014/114, datë 24.12.2019*);
- Interpreton nenet 663 dhe 92 shkronja “a” të K.Civil, në lidhje me kushtet e nevojshme për ekzistencën e një kontrate në raport me pasojat juridike të mungesës së këtyre kushteve, duke përcaktuar se mungesa e kushteve të nevojshme për vlefshmërinë e një kontrate shkakton pavlefshmërinë absolute të saj; nenin 111 të K.Civil në raport me institutin e pavlefshmërisë së pjesshme të veprimit juridik (*vendimi nr. 447/197, datë 21.05.2019*);
- Interpreton paragrafin 3 të nenit 153 të K.Punës, me qëllim dhënien e kuptimit të zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënies së punës; nenin 154/3 të K.Punës në lidhje me dhënien e dëmshpërblimit në rastin e moszbatimit të procedurës në zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës (*vendimi nr.782/338, datë 10.10.2019*);
- Në përputhje me faktet dhe provat, interpreton në mënyrë literate nenet 20, 26/1 dhe 27 të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronës” (*vendimi nr. 291/8, datë 04.04.2019*).

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, evidentohet se gjyqtari në çdo rast ka respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor. Gjyqtari referon dhe zbaton *parimin e zbatimit të ligjit më të favorshëm*, neni 3 paragrafi 3 i K.Penal, sipas të cilit kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale (*vendimi nr. 1014/114, datë 24.12.2019*). Po kështu, në një rast është referuar dhe zbatuar edhe parimi i sigurisë juridike.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën, në shumicën e vendimeve të analizuara rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante, në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, si më poshtë:

- Në funksion të dhënies së kuptimit të interesit të ligjshëm në ngritjen e një padie, gjyqtari i referohet vendimit Unifikues nr.5, datë 30.10.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe për të dhënë kuptimin e legjitimitetit aktiv në raport me natyrën e objektit të padisë, gjyqtari i referohet vendimit Unifikues nr. 4, datë 10.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi nr.392/173, datë 07.05.2019*);
- Gjyqtari citon jurisprudencën e GJEDNJ-së, konkretisht vendimin “*Haldimann dhe të tjerë kundër Zvicrës*” si dhe vendimin “*Couderc dhe Hachette Filipacchi Associes kundër Francës*” në funksion të domosdoshmërisë së ruajtjes së ekuilibrit në ushtrimin e të drejtave. Po kështu, gjyqtari i referohet edhe jurisprudencës së Gjykatës së Kasacionit të Italisë, jurisprudencë e huaj, e cila pavarësisht se nuk është burim i së drejtës sonë, i vjen në ndihmë të interpretimit të nocioneve të reja, duke qenë se ndryshimet janë bërë duke pasur për model edhe legjislacionin procedural penal italian. (*vendimin nr. 1014/114, datë 24.12.2019*);

- Në funksion të legjitimitetit procedural të paditësit, gjyqtari referon edhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për të evidentuar të drejtën e pronësisë, si një prej të drejtave themelore të njeriut (*vendimi nr. 291/8, datë 04.04.2019*).

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet përfundimtare, është e thjeshtë dhe e kuptueshme, në mënyrë që të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Nuk evidentohet përdorim i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Janë përdorur të gjitha shkronjat e gjuhës shqipe, janë respektuar rregullat gramatikore dhe ato të sintaksës në formimin e fjalëve dhe fjalive, duke i bërë vendimet tërësisht të qarta dhe të shkruara në mënyrë korrekte në këtë aspekt.

Termet teknike janë përdorur në mënyrë korrekte, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjin e posaçëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme dhe të ndryshme nga ato juridike. Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet gjyqësore që i nënshtrohen kësaj analize, gjyqtari ndjek në hartimin e tyre një strukturë të qartë, të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari përfshin prezantimin e fakteve, identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe lidhjen e tyre me konkluzionet e arritura. Vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin. Në pjesën hyrëse gjejmë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe pasqyrimi i palëve dhe i shkaqeve të ankimit. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtari ka një metodologji të qartë sipas pjesëve përbërëse të vendimit, ku në mënyrë të posaçme konstatohet se gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë pjesës përshkuese-arsyetuese, duke e organizuar në disa nënpjesë. Konkretisht, në pjesën përshkuese-arsyetuese pasqyrohet “shqyrtimi gjyqësor në shkallë të parë”, ku evidentohen faktet e çështjes, vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë, pretendimet e palëve, të renditura me pika të numërtuara, si dhe ecuria procedurale në shkallë të dytë. Kjo pjesë vijon me konkluzionin e gjykatës lidhur me vendimmarrjen e saj, pas së cilës listohen me pika të gjitha arsyet mbi të cilat është bazuar kjo vendimmarrje, të cilat shërbejnë dhe për ndarjen e paragrafëve nga njëri-tjetri. Në vendimet e vëzhguara, në pjesën përshkuese-arsyetuese gjyqtari i kushton rëndësi identifikimit të natyrës së çështjes, pasqyrimin të fakteve të çështjeve, mënyrës së interpretimit të ligjit dhe mënyrës së çmuarjes së provave nga gjykata e shkallës së parë, pa tejkalluar kufijtë e ankimit.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, disponimi lidhur me të drejtën e ushtrimit të rekursit, afati i ushtrimit të kësaj të drejte, si dhe data e shpalljes së vendimit.

Në vendimin nr. 291/8, datë 04.04.2019, për shkak të shqyrtimit të çështjes si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari në pjesën përshkuese-arsyetuese të vendimit ndalet fillimisht në përcaktimin e saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me juridiksionin dhe kompetencën në lëndë dhe në funksion të saj, duke cituar për këtë qëllim nenin 29 të ligjit nr.133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. *Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa pjesë (edhe pse jo të listuara formalisht si rrethanat e faktit, legjislacioni i zbatueshëm apo vlerësimi dhe analiza juridike, nga mënyra e arsyetimit të vendimit dhe strukturës së përdorur konstatohen lehtësisht), në të cilat në mënyrë të detajuar analizon: (i) rrethanat e fakteve të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, (ii) pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iii) ligjin e zbatueshëm dhe (iv) vlerësimin e gjykatës,*

në të cilën gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij. Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, dhe data e shpalljes së vendimit.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirëpërcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin "Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit" është "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë të saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit për provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në secilin vendim, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, si dhe kategorisë së çështjes apo llojit të vendimit, analiza ligjore zhvillohet në mënyrë logjike, duke u dhënë zgjidhje në mënyrë shteruese të gjitha pretendimeve të palëve në ankim, dhe duke u ndalur në interpretimin e ligjit dhe në mënyrën e aplikimit të tij mbi faktet konkrete, si dhe lidhjen shkak-pasojë mes fakteve të provuara në gjykim, interpretimit të ligjit dhe konkluzioneve të arritura nga gjyqtari lidhur me kërkimet konkrete. Kjo analizë e integruar rezulton veçanërisht në disa vendime, si më poshtë:

- Gjyqtari analizon në mënyrë shteruese të gjitha shkaqet dhe pretendimet e palëve, duke analizuar për çdo pretendim të palëve, dispozitat përkatëse procedurale dhe materiale, në përputhje me rrethanat e faktit dhe provat e administruara. Në këtë aspekt, gjyqtari merr në analizë kufijtë e shqyrtimit në shkallën e dytë të gjykimit, duke analizuar se në kushtet kur në ankimin e paraqitur nga paditësi përsëriten vetëm pretendimet e ngritura në kërkesëpadi, pa kundërshtuar arsyetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e këtyre pretendimeve, atëherë objekt i shqyrtimit do të jetë verifikimi i pretendimeve të përsëritura, pa tejkalar kufijtë e këtij ankimi, në respektim të nenit 465/1 të K.Pr.Civile. Gjyqtari analizon gjerësisht legjitimitetin aktiv në ngritjen e një padie në mënyrë të përgjithshme, por edhe në raport me natyrën e padisë objekt gjykimi. Gjyqtari, në kuptim të nenit 32/a të K.Pr.Civile dhe konkluzioneve të vendimeve unifikuese nr.5, datë 30.10.2012 dhe nr.4, datë 10.12.2013, analizon se legjitimitetin aktiv për njohjen apo rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar e ka vetëm ai, të cilit i përket sipas ligjit e drejta e mohuar apo e shkelur. Në vijim, gjyqtari argumenton se legjitimitetin pasiv e ka ai që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuarit. Duke dhënë kuptimin e legjitimitetit aktiv në raport me natyrën e objektit të padisë nëpërmjet të cilës synohet rivendosja e të drejtës subjektive, si dhe provave shkresore dhe me ekspert, gjyqtari ka konkluduar se

paditësi nuk e ka legjitimitetin në ngritjen e padisë objekt shqyrtimi (*vendimi nr. 392/173, datë 07.05.2019*);

- Gjyqtari analizon elementët e veprës penale të parashikuar në nenin 121 të K.Penal, duke iu referuar parashikimeve të kësaj dispozite para dhe pas ndryshimeve me ligjin nr.44/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.78958, datë 27.01.1995 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me kualifikimin juridik të faktit penal për të cilin akuzohet i pandehuri, mbështetur në faktet e çështjes dhe provat përkatëse. Në këtë kontekst, gjyqtari ka arsyetuar se mbi bazën e analizimit krahasimor të elementëve të anës objektive të kësaj veprë penale para dhe pas ndryshimeve me ligjin 49/2019, evidentohet ekzistenca e një dallimi esencial në lidhje me faktet, për të cilat është deklaruar fajtor i pandehuri. Sipas analizës së gjyqtarit, pas ndryshimeve të dispozitës, vetëm publikimi i të dhënave të jetës private të personit të marra në mënyrë të fshehtë, (*nëpërmjet vendosjes së aparaturave që shërbejnë për dëgjimin apo regjistrimin e fjalëve ose figurave, fiksimit ose regjistrimit të figurave si dhe ruajtja e këtyre të dhënave për publikim*) përmban elementë të anës objektive të veprës penale “Ndërhyrje e padrejtë në jetën private”, dhe jo publikimi i të dhënave private që nuk janë marrë në mënyrë të fshehtë. Evidentohet se gjyqtari, duke analizuar gjerësisht shkeljet etike të kryera nga i akuzuari,⁴ mungesën elementëve të veprës penale “Ndërhyrje e padrejtë në jetën private”, si dhe ndalesën ligjore për të marrë në shqyrtim akuzat e reja që janë ngritur veçmas dhe jo në mënyrë alternative nga viktima akuzuese, ka arritur në përfundimin e mungesës së përgjegjësisë penale të të akuzuarit (*vendimi nr. 1014/114, datë 24.12.2019*);
- Gjyqtari analizon kriteret për ngritjen e kërkesës me objekt: “Vërtetimin e faktit juridik” si interesi i ligjshëm, mungesën e aktit dhe pamundësinë e ribërjes së tij apo marrjen e aktit në ndonjë rrugë tjetër. Gjyqtari analizon përmbajtjen e nenit 29 të K.Pr.Civile në raport me provat e administruara në gjykim (*vendimi nr. 749/110, datë 02.10.2019*);
- Gjyqtari, duke interpretuar nenet 253, 269/3, 270, 275 të K.Pr.Civile në lidhje me fuqinë provuese të akteve zyrtare dhe falsitetin e shkresave, analizon se në referim të përmbajtjes së akteve shkresore, rezulton se kryerja e aktit të ekspertimit grafik është e bazuar në akte origjinale të së njëjtës kohë dhe të përafërta me atë objekt ekspertimi, vërtetësia e të cilave nuk është kundërshtuar as nga pala e paditur ankuese. Gjyqtari analizon lidhur me disponimin nga ana e prokurorisë apo gjykatës penale të dokumentit të falsifikuar, në raport me eliminimin e pasojave të falsitetit, sipas 275 të K.Pr.Civile. Në këtë kontekst, gjyqtari analizon se karakteri i plotë apo i pjesshëm i falsitetit të shkresës origjinale që shpallet e falsifikuar gjatë gjykimit civil nuk paraqet rëndësi për urdhërimin e depozitimit për ruajtje të kësaj shkrese të falsifikuar në arkivin e gjykatës. Gjyqtari çmon për rënien në dekadencë të kërkimeve apo pretendimeve të palëve, për të cilat nuk është ushtruar ankim, në interpretim të nenit 459 të K.Pr.Civile. (*vendimi nr. 447/197, datë 21.05.2019*);
- Gjyqtari analizon kushtet ligjore për zëvendësimin e masës së sigurimit “Sekuestro konservative”, (*neni 207 i K.Pr.Civile*). Duke analizuar vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, gjyqtari ka argumentuar se pala paditëse ka shprehur kundërshtimin për zëvendësimin e kësaj mase sigurimi me arsyetimin e vazhdimësisë së ekzistencës të të njëjtave arsyeve që e bëjnë të pamundur apo të vështirë ekzekutimin e vendimit për të drejtat pasurore të paditësit, në eventualitetin e pranimit të padisë. Në këtë kontekst, gjyqtari analizon se mbi bazën e provave të paraqitura nga pala e paditur nuk provohet të kenë ndryshuar shkaqet apo arsyet mbi bazën e të cilave është vendosur masa e sigurimit “Sekuestro konservative” (*vendimi nr.23/14, datë 11.01.2019*);

⁴ Evidentohet se gjyqtari analizon kuptimin gjuhësor dhe të përdorimit të përditshëm mediatic të termit “overdozë”, analizon parimet e Kodit të Etikës së Gazetarit, që kanë të bëjnë me saktësinë dhe ndershmërinë e informacionit dhe dallimin ndërmjet faktit dhe opinionit.

- Gjyqtari analizon kushtet që duhen të plotësohen në mënyrë kumulative për të qenë para zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës, duke analizuar dispozitat përkatëse materiale dhe procedurale, në raport me faktet e çështjes dhe duke ia nënshtruar analizës juridike çdo provë të lejuar dhe të marrë në shqyrtim nga Gjykata e Shkallës së Parë. Duke analizuar faktet e provuara në gjykim, gjyqtari ka analizuar se për sa kohë kontrata e punës është zgjidhur me paditësin për shkaqe të justifikuara, me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë ka arritur në përfundimin se paditësit nuk i takon as dëmshpërblimi për mosrespektim të afatit të njoftimit, pasi pavarësisht se në parim palët e një kontrate pune duhet të respektojnë afatin e njoftimit, në mënyrë përjashtimore mosrespektimi i afatit të njoftimit nga ana e palës që ka zgjidhur kontratën në mënyrë të njëanshme nuk është i ndëshkueshëm në rast se kontrata është zgjidhur për shkaqe të justifikuara. Gjyqtari, duke interpretuar nenin 154/3 të Kodit të Punës, në raport me faktet e provuara në gjykim, ka arritur në përfundimin se vendimmarrja e Gjykatës së Shkallës së Parë për rrëzimin e kërimit për dhënien e dëmshpërblimit për mosrespektimin të procedurës është një vendimmarrje e drejtë. Gjyqtari analizon ndryshimet që ka pësuar neni 144 i Kodit të Punës me ligjin 136/2015, i cili ka shfuqizuar paragrafin e katërt të kësaj dispozite, në të cilën parashikohet detyrimi për respektimin e procedurës edhe në rastin e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës për shkaqe të justifikuara. Gjyqtari analizon të drejtën e shpërblimit për vjetërsi, duke zbatuar dispozitën e parashikuar nga neni 154/4 i Kodit të Punës, në raport me faktet e provuara në gjykim. Në vijim të kësaj analize, duke iu referuar objektit të padisë dhe përmbajtjes së nenit 6 të K.Pr.Civile, gjyqtari ka evidentuar mungesën e shqyrtimit të këtyre kërtimeve nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë. Duke evidentuar shkeljet procedurale të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke interpretuar nenin 467, shkronja "e", të K.Pr.Civile, të ndryshuar me ligjin 38/2017 në raport me nenin 121 të K.Pr.Civile, në të cilin parashikohet pavlefshmëria e pjeshme e aktit procedural, gjykata ka disponuar për prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim për kërkimet e pashqyrtuara nga Gjykata e Shkallës së Parë (*vendimi nr.782/338, datë 10.10.2019*);
- Gjyqtari analizon konceptin e legjitimitetit procedural të paditësit për të kërkuar të drejtën e pronësisë, duke e cilësuar si një prej të drejtave themelore të parashikuar si të tillë nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr.1 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut. Gjyqtari analizon në mënyrë të detajuar parimin e "*sigurisë juridike*" duke analizuar përmbajtjen e vendimit të ish-ZRKK Qarku Gjirokastrë në lidhje me mosnjohjen e të drejtës së pronësisë, paditësit. Nga interpretimi literal dhe sistematik i neneve 20, 26/1 dhe 27 të ligjit nr. 133/2015 "*Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronës*", gjyqtari çmon se objekt shqyrtimi nga ana e Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë vetëm kërkesat e patrajuara më parë dhe jo ato të trajtuara dhe të shqyrtuara në themel, për të cilat ka patur një vendimmarrje të mëparshme nga ish-komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave që kanë kaluar në vite, para hyrjes në fuqi të ligjit 133/2015. Duke referuar në përmbajtjen e vendimeve nr.27, datë 26.05.2010 dhe nr.43, datë 06.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese, në aplikim të fakteve të çështjes, gjyqtari ka analizuar se me të drejtë Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vendosur të mos pranojë kërkesën e re të paditësit pa e shqyrtuar në themel, duke pasqyruar në mënyrë të detajuar arsyet e këtij qëndrimi dhe duke e cilësuar vendimin e dhënë në emër të subjektit të shpronësuar për të njëjtën pronë si "*gjë të gjykuar*" (*vendimi nr.291/8, datë 04.04.2019*).

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse, në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u parashtruar në mënyrë të detajuar në pjesën e parë të arsyetimit dhe më pas duke u marrë në analizë lidhur me bazueshmërinë ose jo të tyre, në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimin

konkret. Duke u marrë në shqyrtim dhe duke analizuar jo në një pjesë të veçuar të arsytimit, por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret, pretendimet e palëve marrin një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose në prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme, si pjesë e arsytimit të vendimit.

Në tërësi, në të gjitha vendimet e gjyqtarit, analiza ligjore, si në lidhje me aspekte procedurale të zhvillimit të gjykimit, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimin e atyre, ashtu edhe në analizën ligjore të veprës penale ose objektit të çështjes në shqyrtim, zhvillohet e plotë, e thellë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Analiza përmbush në çdo rast jo vetëm standardet e procesit të rregullt ligjor, por pasurohet edhe me qëndrime të praktikës gjyqësore, të cilat duket se janë në vëmendje të veçantë të gjyqtarit, duke u integruar në mënyrë të natyrshme dhe në masën e duhur në arsytim. Kjo mënyrë arsytimi i jep vlerë të shtuar dhe cilësi të lartë analizës dhe argumentimit të vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 23 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtarë”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit” dhe “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”. Duke iu referuar objektit të çështjeve të pasqyruara në tabelat me të dhëna statistikore, rezulton se çështjet janë me objekt:

- “Kundërshtim veprimesh përmbare”, për të cilat neni 610 i K.Pr.Civile, i ndryshuar,⁵ parashikon se duhet të shqyrtohen brenda 30 apo 45 ditëve nga marrja e akteve;
- “Ankimi kundër masave të sigurimit”, për të cilat neni 249 paragrafi i pestë i K.Pr.Penale,⁶ parashikon se duhet të shqyrtohen brenda 10 ditëve nga marrja e akteve;
- “Ankim ndaj mosfillimit të procedimit penal”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 291 pika 5 të K.Pr.Penale,⁷ duhet të shqyrtohen nga gjykata brenda 30 ditëve nga marrja e akteve;
- “Shuarja e masës së sigurimit”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 261 pika 3 të K.Pr.Penale,⁸ duhet të shqyrtohen brenda 48 orëve nga momenti i paraqitjes;
- “Rivendosje në afat të ankimit”, të cilat sipas parashikimeve të nenit 147 pika 4 të K.Pr.Penale,⁹ shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja e akteve.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se nga 24 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi,¹⁰ vetëm 1 (një)¹¹ prej tyre është shqyrtuar në tejkallim të këtij afati. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (1 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (24 çështje), gjyqtari rezultojnë që të ketë gjykuar 4.16 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari i gjykatës parashtrajnë se referuar të dhënave statistikore në tabelën përmbledhëse të vitit 2019 rezultojnë se nuk ka asnjë çështje që të jetë gjykuar në tejkallim të afatit ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, klasifikohet nga “0-10 %”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

⁵ Neni 610 paragrafi 6 dhe 7 i K.Pr.Civile parashikon se: “Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për kundërshtimin e veprimeve përmbare, si rregull, bëhet nga gjykata e apelit pa praninë e palëve, brenda 30 ditëve. Përgjithësisht, gjykata e apelit mund të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve brenda 45 ditëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, në afatet e parashikuara; b) vendimi, kundër të cilit është paraqitur ankimi, është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë”.

⁶ Neni 249 pika 5 i K.Pr.Penale parashikon se: “Ankimi shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja e akteve”.

⁷ Neni 291 pika 5 i K.Pr.Penale parashikon se: “Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve. Gjykata e apelit vendos brenda 30 ditëve nga marrja e akteve”.

⁸ Neni 261 pika 3 i K.Pr.Penale parashikon se “Kërkesa për shuarjen e masës së sigurimit paraqitet së bashku me provat në gjykatën ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së saj. Gjykata vendos brenda 48 orëve, pasi njofton palët. Mosparaqitja e palëve, pa shkaqe të arsyeshme, nuk e pengon gjykatën të vendosë pa praninë e tyre. Për afatin e arsyetimit të vendimit dhe ankimit zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi”.

⁹ Neni 147 pika 4 i K.Pr.Penale parashikon se “Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve”.

¹⁰ Në Tabelën nr.1 çështjet me numër rendor 22, 34, 45, 55; Në Tabelën nr.2. çështja me numër rendor 15; Në Tabelën nr.10 të gjitha çështjet (me numër rendor 1- 18), si dhe në Tabelën nr.12 çështja me numër rendor 1.

¹¹ Në Tabelën nr.2. çështja me numër rendor 15;

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit viti 2019, rezulton se gjyqtari ka gjykuar në total 149 (njëqind e dyzet e nëntë)¹² çështje në cilësinë e relatorit nga të cilat 54 (pesëdhjetë e katër) çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, 24 (njëzet e katër) çështje të kategorisë “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, 10 (dhjetë) çështje të kategorisë “Familjare me palë kundërshtare”, 7 (shtatë) çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune”, 12 (dymbëdhjetë) çështje të kategorisë “Penale krime”, 5 (pesë) çështje të kategorisë “Penale kundërvajtje”, 9 (nëntë) çështje të kategorisë “Seancë paraprake”, 2 (dy) çështje të kategorisë “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit” dhe 26 (njëzet e gjashtë) çështje të kategorisë “Juridiksion fillestar”, për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së, përcakton këto standarde minimal kohore gjykimi në gjykatën e apelit: jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të përgjithshme; jo më tej se 4 muaj për gjykimet civile pa palë kundërshtare, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim, si dhe jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave penale.

Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit standard minimal kohor (12 çështje),¹³ me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (149 çështje), rezulton se 8,05% e tyre kanë përfunduar jashtë standardit minimal kohor në fuqi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “0-10 %”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër ose e barabartë me standardin minimal kohor të miratuar për të gjitha kategoritë e çështjeve. Konkretisht:

- Në kategorinë e çështjeve “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 69 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 29 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 28.6 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

¹² Pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen afate ligjore gjykimi.

¹³ Tabela nr.1 çështjet me numër rendor 5, 11, 12, 35, 41; Tabela nr.2 çështja me numër rendor 16; Tabela nr.9 çështjet me numër rendor 1, 2, 3, 5; Tabela nr.14 çështjet me numër rendor 16, 25;

- Në kategorinë e çështjeve “marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 69 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “penale krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 47 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “penale kundërvajtje”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 68 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “seanca paraprake”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 11.5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 29.5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “juridiksion fillestar”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 68 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj.

Rezulton se standardi minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së, për kategorinë e kundërvajtje penale është kaluar vetëm me 8 (tetë) ditë. Nga të dhënat statistikore evidentohet se në dy prej këtyre çështjeve afati minimal kohor është kaluar me 4 apo 9 ditë, konkretisht, çështja penale nr. 18/146 akti është shortuar në mesin e muajit dhjetor, duke u mbartur për gjykim në vitin pasardhës. Javën e parë të muajt janar administrata gjyqësore kryen procedurën e mbartjeve të dosjeve, çka sjell pamundësinë e zhvillimit të seancave gjyqësore gjatë kësaj jave, dhe nëse kësaj çështjeje nuk do t'i llogaritej kjo periudhë kohore, atëherë çështja do të kishte përfunduar për 54 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 60 ditësh. Po kështu, edhe për çështjen penale nr. 64, të shortuar në muajin korrik, nëse nuk do të përfshihet në përlogaritjen e afatit minimal muaji gusht, që korrespondon me periudhën e lejes vjetore të gjyqtarëve, atëherë kjo çështje do të konsiderohet e përfunduar për 41 ditë, pra brenda standardit minimal kohor.

Për sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e integruar burimeve të vlerësimit, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara (173 çështje),¹⁴ me numrin e çështjeve të caktuara (196 çështje)¹⁵ brenda vitit kalendarik, është 88%.

¹⁴ 170 çështje të përfunduara në cilësinë e relatorit në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, 1 çështje përfunduar në cilësinë e relatorit në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe 2 në Gjykatën e Apelit Korçë;

¹⁵ 193 çështje të caktuara në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, 1 çështje caktuar në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe 2 në Gjykatën e Apelit Korçë;

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Mbi 87-93%”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 9.9 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 6.2 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsytimit është 9.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsytimit është 10 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.
- Për çështje të kategorisë “penale krime”, koha mesatare e arsytimit është 13.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 430/1, paragrafi 4, i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “penale kundërvajtje”, koha mesatare e arsytimit është 21.4 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë, i parashikuar nga neni 430/1, paragrafi 4, i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 4.7 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 10 ditë, i parashikuar nga neni 249/6 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 11.8 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë, i parashikuar nga neni 430/1 paragrafi 4 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “seancë paraprake”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (*pushim procedimi*), koha mesatare e arsytimit është 19.5 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë, i parashikuar nga neni 430/1 paragrafi 4 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është 10 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë, i parashikuar nga neni 430/1 paragrafi 4 i K.Pr.Penale.
- Për çështje të kategorisë “juridiksion fillestar”, koha mesatare e arsytimit është 5.1 ditë, për të cilën nuk rezulton që të jetë parashikuar një afat ligjor për arsyetimin e vendimit, e në këtë kontekst, rezulton të jetë më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 20 ditë, i parashikuar nga neni 308/2 i K.Pr.Civile.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe Raportit Analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përfshirë ato pa palë kundërshtare, për kategorinë “civile me palë kundërshtare” është 2.5 seanca, për kategorinë “familjare me palë kundërshtare” është 1.1 seanca, për kategorinë “marrëdhënie pune” është 1.4 seanca, për kategorinë “penale krime” është 2.3 seanca, për kategorinë “penale kundërvajtje” është 4.6 seanca, për kategorinë “seancë paraprake” është 1 seanca dhe për kategorinë “juridiksion fillestar”¹⁶ është 4.6 seanca. Në total, numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh është 2.5 seanca.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari ka parashtruar se për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë së kundërvajtjeve penale, numri mesatar i seancave gjyqësore është nga 1-3. Gjithashtu, ai parashtron se në rastin e kundërvajtjeve penale, numri mesatar i seancave shkon mbi 3, për shkak se: i) në çështjen penale nr. 18/46, një seancë gjyqësore është shtyrë brenda të njëjtës ditë, në përputhje me parimin e gjykimit të pandërprerë, dy seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mosnjohimit të të akuzuarit nga nëpunësi gjyqësor dhe të mosparaqitjes të mbrojtësit të të akuzuarit për shkak të pamundësisë së lëvizjes, si rezultat i reshjeve të dëborës në datën 10.01.2019 dhe një seancë gjyqësore është shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, si rezultat i mosparaqitjes për shkaqe objektive të njërit prej anëtarëve të trupit gjykues. Në të vetmen seancë produktive të zhvilluar, është disponuar me vendimin përfundimtar; ii) në çështjen penale nr. 33, dy seanca janë shtyrë për shkak të problemeve të njoftimit për viktimën nga vepra penale dhe për të pandehurin, një seancë është shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, në kushtet e mosparaqitjes për shkaqe objektive të kryesuesit të seancës dhe dy seanca janë shtyrë për shkak të kërkesave të të pandehurit për t’u mbrojtur nga avokati i zgjedhur prej tij; iii) në çështjen penale nr. 114, seancat gjyqësore janë shtyrë për t’u mundësuar palëve, me kërkesë të tyre dhe sipas përcaktimeve të nenit 338 të K.Pr.Penale, zgjidhjen e çështjes me pajtim.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar Raportit Analitik dhe akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët;

¹⁶ Këtu janë përfshirë vetëm çështjet me palë kundërshtare, konkretisht çështjet me numër rendor nga 16 deri në 26;

- Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosfomimit të trupit gjykues, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesë të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: për t'i lënë kohë përfaqësuesit të palës për tu njohur me aktet e dosjes për një përfaqësim efektiv, lënien kohë palës për të plotësuar të metat e padisë, mosparaqitja e palëve, etj.;
- Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore, konstatohet respektimi në çdo rast i afatit ligjor për caktimin e seancave (*respektimi i afatit procedural sipas parashikimeve të nenit 426 të K.Pr.Penale*);
- Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore, konstatohet respektimi në çdo rast i afatit të arsyeshëm, më i shkurtër se 15 ditë, për caktimin e seancave.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, aftësia e gjyqtarit është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari në çështjet civile ka vënë në lëvizje duke proceduar me nxjerrjen e vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke urdhëruar njoftimin për ditën dhe orën e gjykimit për palët ndërgjyqëse, nëpërmjet shpalljes në ambientet e gjykatës së apelit dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë, si dhe nëpërmjet njoftimit individual, në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit. Shpallja ose njoftimi është bërë duke respektuar afatin procedural 15 ditor të parashikuar nga neni 460/5 i Kodit të Procedurës Civile. Po kështu, edhe në çështjen penale të përzgjedhur për vlerësim, evidentohet se gjyqtari e ka vënë në lëvizje duke proceduar me nxjerrjen e vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar nga neni 426/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, të mbajtur me sistemin e regjistrimit audio, si dhe janë pasqyruar në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të shqyrtimit të çështjes në apel, sipas parashikimeve të neneve 460 e vijues të K.Pr.Civile. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, për relatimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, shpalljen e trupit gjykues, deklarimin e hapur të diskutimit, relatimin nga kryetari i trupit gjykues në mënyrë të përmbledhur të dosjes gjyqësore dhe të shkaqeve të ngritura në ankim, parashtrimin e pretendimeve nga palët, dhënien fund shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancave është zhvilluar në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (në rastet e disponimit për kërkesat e palëve, përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, shtyrjen e seancës, etj.).

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, me përjashtim të ndonjë rasti të çeljes me vonesë, shoqëruar me relativitetin e shkakut që ka shkaktuar vonesën në çeljen e seancës, por nuk rezultojnë seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 6 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezultojnë se dosjet janë të renditura në mënyrë të rregullt, duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik (sipas kategorive të akteve) dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 6 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme, duke përmbajtur aktin e shortit, vendimin për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, aktet e dorëzuara nga palët (*kërkesë për shtyrje të seancës gjyqësore, kërkesëpadi, provat, deklaratë mbrojtje e palës së paditur*),¹⁷ procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimin përfundimtar të gjykatës, si dhe CD-në e regjistrimit audio të seancave gjyqësore.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

¹⁷ Në çështjen me nr. 20-2019-291/8, datë 04.04.2019 gjykuar si gjykatë e shkallës së parë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, aktet e hartuara nga gjykata (vendimi për kalimin e çështjes për shqyrtim gjyqësor, njoftimet për palët ,procesverbalet e çdo seance, vendimet përfundimtare).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
96	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për gjyqtarin Enton Dhimitri, gjatë periudhës së vlerësimit nuk janë dhënë ose zbatuar masa disiplinore.

Sa i përket ankesave, për periudhën e vlerësimit viti 2019, ndaj gjyqtarit rezulton të jenë paraqitur dy ankesa. Pas verifikimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.1072/8

Prot., datë 08.02.2021 dhe nr.1150/4 Prot., datë 29.12.2020,¹⁸ ka vendosur arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultateve të verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

Ankesa e subjektit K.S.Sh., depozituar në KLGJ me nr. 2286 Prot., datë 18.04.2019, regjistruar në Zyrën e ILD me nr. 1072 Prot., datë 10.06.2020, konsiston në pretendimet që lidhen me mosrespektim të ligjit procedural, mosnjohimin e ankuesit për datën dhe orën e gjykimit. Lidhur me këtë ankesë, ILD ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, me vendimin nr. 1072/8 Prot., datë 08.02.2021 duke arsyetuar se: *“Nisur nga sa më sipër, nga të gjitha aktet e grumbulluara në funksion të verifikimit të ankesës, mungojnë dyshimet e arsyeshme të cilat të justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102/1 shkronjat “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

Ankesa e dytë është paraqitur nga shtetasi I.J., në KLGJ me nr. 2515 Prot., datë 06.05.2019, përcjellë në Zyrën e ILD me nr. 1150 Prot., datë 15.06.2020, dhe konsiston në pretendimet që kanë të bëjnë me zgjidhjen e çështjes në themel. Lidhur me këtë ankesë, ILD ka vendosur arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, me vendimin nr. 1150/4 Prot., datë 19.12.2020 duke arsyetuar se: *“Nga ana tjetër pretendimet në ankesë janë për zgjidhjen në themel të çështjes me vendim përfundimtar, dhe çdo pretendim tjetër i kësaj natyre zgjidhet mbi apelimin gjyqësor nga një gjykatë me e lartë. Nga informacioni paraprak i marrë në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë rezulton se ndaj vendimit nr. 20-201-968/567, datë 12.10.2015 të dhënë nga trupa gjyqësore në të cilën gjyqtari Enton Dhimitri është anëtar, është paraqitur rekurs dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë, ku ndodhet në fazë studimi. Pretendimet e parashtruara në ankesë ndaj gjyqtarit Enton Dhimitri nuk vlerësohet të jenë të natyrës së shkeljeve disiplinore të parashikuara nga nenet 101-103 të ligjit nr. 96/2016”.*

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarit në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

¹⁸ Vendimet për verifikimin e ankesave janë dërguar nga ILD me shkresat me nr. 1814/2 Prot., datë 09.02.2021 dhe i përkasin ankesave të subjektit K.S.P.Sh dhe shtetasit I.J.

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton të jenë regjistruar në ILD dy ankesa, të trajtuara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimet nr.1072/8 Prot., datë 08.02.2021 dhe nr.1150/4 Prot., datë 29.12.2020, në të cilët është vendosur arkivimi i ankesave, pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se nuk plotësojnë kushtet e pranueshmërisë, për shkaqet e referuar në analizën e mësipërme.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjtetin dhe pritshmërinë e publikut.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtarit Enton Dhimitri, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr.201/23 Prot., datë 21.07.2020, konkludohet se *deklarimi i pasurisë është i saktë dhe në përputhje me ligjin; ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, gjyqtari pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjtetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjteti” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe vlerësimi i kryetarit të gjykatës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2019–31.12.2019, janë paraqitur 4 (katër) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, të cilat janë rrëzuar të gjitha. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtari ka paraqitur 31 (tridhjetë e një) kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 26 (njëzet e gjashtë) janë pranuar dhe 5 (pesë) janë rrëzuar.

Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”, duke qenë se nuk rezulton asnjë kërkesë e paraqitur dhe pranuar për përjashtimin e tij nga gjykimi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent dhe i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet komunikimi i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. I njëjti konstatim rezulton edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë.

Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit në nivel shumë të lartë.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale, përfshirjen në diskutime ligjore, organizimin e punës në gjykatë dhe komunikimin brenda trupave gjyqësore.

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari dhe kryetari i gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtari Enton Dhimitri, gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në 10 (dhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 19 ditë trajnimi.

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.* Në rastin konkret,

gjqytari ka marrë pjesë në 10 aktivitete trajnuese të shtrira në 19 ditë trajnimi, brenda kufijve minimalë dhe maksimalë (5 deri në 40 ditë në vit) të përcaktuar nga Ligji për Statusin, duke përmbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese të përshtatshme për funksionin e tij dhe që i përkasin fushës së veprimtarisë së tij, pasi rezultojnë të jenë aktivitete me tema të së drejtës civile dhe penale.

***Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime është nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019), duke e pikëzuar me 20 pikë.*

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se gjyqtari Enton Dhimitri, përgjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, nuk ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertit apo lehtësuesit për trajnimin e gjyqtarëve. Po kështu, nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e tij në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtar gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do u shtohen në rast të vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Enton Dhimitri, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

***Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me këtë tregues, rezulton se me vendimin e Këshilli të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, gjyqtari është caktuar si Gjyqtar për Mediat në juridiksionin e Apelit Gjirokastër.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Enton Dhimitri, duke qenë se rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna. Për pasojë, në mungesë të të dhënave për këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me zero pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike”, nuk rezulton angazhim i gjyqtarit dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.*

KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI
DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT**

Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer prej tij, propozon nivelin e vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit.

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	96	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	389	Shkëlqyeshëm

PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të ligjit nr. 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari Enton Dhimitri të mbajë në konsideratë angazhimin e tij të vazhdueshëm në aktivitetet për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

SHTOJCA 1

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN ENTON DHIMITRI
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019- 31 DHJETOR 2019**

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli treguesit
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër standardi për shumicën e

		kryetarit	kategorive të çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi 87- 93 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë
--	--	---	---------------

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/nivel treguesit
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshë

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/nivel treguesit
---------	--	--------	------------------------------------

A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT			SI